

REKO



Circular Economy
Kosovo



EECSOK



RILINDJA
GJELBËR

A e dini sa ushqim po humbet çdo vit?



Sipas UNEP, në vitin 2022 janë gjeneruar 1.05 miliardë tonë mbetje ushqimore (përfshirë pjesët e pangrënshme)



132 KG
PËR PERSON



**GATI 1/5 E GJITHË USHQIMIT TË
DISPONUESHËM PËR KONSUMATORËT**

Ekonomia qarkore në industrinë ushqimore është pjesë e zgjidhjes.



Për të reduktuar këto humbje, modelet e ekonomisë qarkore janë kyçe.



SHEMBUJ NGA BOTA QË PO FUNKSIONOJNË:



Mbiciklon mbetje si lëvozhga vezësh apo drithëra të përdorur në përbërës të rinj ushqimorë



Lidh ushqimin e tepërt me pika ku mund të shpëtohet për konsum



Përdor insekte dhe teknologji biologjike për të shndërruar mbetjet organike në ushqim për kafshë dhe pleh



Platformë globale që shpëton miliona vakte ushqimore çdo vit duke lidhur restorante, dyqane dhe konsumatorë



EDHE NË KOSOVË KA HAPA KONKRETË:



Grumbullimi i vajit ushqimor të përdorur në gastronomi

Vaji i përdorur nuk hidhet më në kanalizim

Ai mbledhet dhe eksportohet jashtë Kosovës ku ripërdoret si lëndë e parë për produkte të reja (p.sh. biodiesel), duke reduktuar ndotjen dhe humbjet.

Ripërdorimi i mbetjeve nga vajrat bimore

Nënproduktet dhe mbetjet nga përpunimi i vajrave mund të shndërrohen në inpute për industri të tjera, duke krijuar vlerë të re nga ajo që më parë konsiderohej mbetje.

Ekonomia qarkore nuk është ide e largët, ajo po ndodh tash, edhe këtu.



Çka tjetër mund të bëjmë në Kosovë?

- ▶ Parandalim i humbjeve ushqimore
- ▶ Riciklim & kompostim i mbetjeve organike
- ▶ Bashkëpunim mes gastronomisë, bizneseve dhe ricikluesve
- ▶ Modele qarkore që kursejnë burime dhe mbrojnë mjedisin

Ekonomia qarkore në industrinë ushqimore është pjesë e zgjidhjes!

